Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**29.01.2024**	**09.02.2024**	**2024/0066**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.01.2024, OE “DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0066, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sherbime per Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim per Ndertesat Qeveritare -Ri tender” me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0066 i dt:22.01.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji per prokurim Publik, nr. 04/L-042, i amandamentuar.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullorja per Prokurim Publik 001/2022

- Neni 17 Dosja e Tenderit
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 97, i rregullores nr. 001/2022

Me datën 10/11/2023, AK – MPB, ka publikuar formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues sa i përket procedurës se prokurimit me titull "Matja e Hidrostatikes dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit" me numër te prokurimit: 214-23-3593-2-2-1, ku procedura e prokurimit tentohet përsëri te anulohet, përkundër faktit se OSHP me vendimin e datës 24/08/2023, e ka obliguar AK-MPB, qe te bëje rivlerësim te ofertave bazuar ne kërkesat e përcaktuara ne Dosje te Tenderit dhe ne Njoftim për Kontrate. OE ankues "PROGLOBAL"SHPK, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se e ka kundërshtuar propozimin për anulim, ka kërkuar qe te zbatohen dispozitat ligjore dhe urdhri nga OSHP-se. Kjo procedure e prokurimit eshtë publikuar ne muajin prill te këtij viti dhe ende AK – MPB e prolongon përkundër faktit se OSHP, përmes vendimit ka konstatuar se AK – MPB, ka shkelur dispozitat ligjore.

Pretendimi ankimore 1.

Arsyetimi i anulimit te aktivitetit te prokurimit i potencuar ne letër standarde se:

"Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do te ndodhe ne procedure te prokurimit dhe se Komisioni Profesional pas shqyrtimit te ofertave ka shqyrtuar kërkesën për inicim nga njësia kërkuese, kërkese kjo e bartur ne aneksin 1 Specifikacioni i detyrueshëm ka parregullsi ne specifikat teknike" përkatësisht arsyetimi se "me listën e çmimeve – matja e hidrostatikes dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit eshtë kërkuar matje dhe mbushje e te gjitha aparateve përnjëherë dhe nuk eshtë cekur ne ketë liste matja e hidrostatikes

dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit, se do te realizohet ne dy faza te rimbushjes përgjatë kontratës se nënshkruar", ne fazën pas vlerësimit dhe rivlerësimit te ofertave, paraqet shkelje flagrante te dispozitave ligjore te nenit 62 te LPP-se dhe nenit 97, te Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Përveç kësaj, anulimi i aktivitetit te prokurimit ne ketë faze te prokurimit AK-ne – Zyrën e Prokurimit dhe komisionin rivlerësues te ofertave e implikon me shkelje te rende ligjore te përcaktuar me nenin 97 te Rregullores 001/2022 pika h) dhe k) ku përcaktojnë se:

h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së

k) Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

5/4

Pretendimi ankimore 2.

AK – MPB, tani pas kërkesës për ri shqyrtim ne arsyetim te vendimit, përshkruan kërkesa te aneksit 1 te dosjes se tenderit pozicionin 16, ku eshtë përshkruar se Afati i kontratës do te parashihet qe te përfundoj brenda 36 muajve (3 vite).

Faza e pare e trajtimit do te jete menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe e dyta dy vite pas fazës se pare dhe pozicionin 17. OE-te duhet te fillojnë punën menjëherë pas nënshkrimit te kontratës e cila do te realizohet ne dy faza te rimbushjes përgjatë kontratës se nënshkruar.

Kjo qeshtje eshtë absurde arsyetimi i anulimit bie ndesh me nenin 62, te LPP-se.

Kjo procedurë e prokurimit eshtë publikuar me datën 13.04.2023, dhe AK ende nuk e prolongon e neglizhon procedurën përderisa arsyetohet ne faza dhe veprime përgjatë procesit te kohëzgjatjes se kontratës, përderisa pajisjet ekzistente dhe furnizimet mbeten pezull si rezultat i vet pezullimit te procedurës se prokurimit, ku rreziku është permanent nga veprimet apo mos veprimet te cilat i atribuohen zyrtareve përgjegjës te AK-se

Neni 17.12 i RRPP-se, përcakton:

Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në

fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve.

Pra OE-te ne ketë faze te prokurimit apo edhe për teke te AK-se dhe zyrtareve te caktuar nuk mund ta pësojnë ne ketë faze, ku tani me është hera e trete qe neve si OE, kërkojmë qe ti realizojmë te drejtat tona te garantuara me ligj dhe kjo gjë po vazhdon te na shkakton dëme morale dhe materiale, përfshirë hartimin e shkresave depozitën dhe bllokimin e mjeteve materiale dhe shumë çështje tjera.

Pretendimi ankimore 3.

Autoriteti Kontraktues, pas hapjes se ofertave, pas vlerësimit, pas ri vlerësimit dhe pas urdhrit te OSHP-se, nuk mund ta anuloj aktivitetin e prokurimit.

Procedura e prokurimit e iniciuar nga AK, ka te beje me kontrate publike kornize – 36 muaj apo 3 vjeçare dhe sipas nenit 38 te LPP-se, i trajton kontratat kornize dhe përqindjen e tyre, përkatësisht par. 2 përcakton qe:

6/4

2. "...Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht."

Prandaj AK, bazuar ne llojin e procedurës, është dashtë qe te veproj sipas dispozitës se larte përshkruar ligjore.

1. Aneksi 1 Specifikacionet Teknike te Detyrueshme eshtë i qarte se bashku me listën – përshkrimin e çmimeve ku eshtë përcaktuar se OE duhet te ofroje çmimin për dy trajtime te aparateve te zjarrit – matjen hidrostatike dhe rimbushjen AKZ, prandaj ne si OE edhe tek paramasa dhe parallogaria kemi ofruar çmimin për trajtim dy here i cili do te realizohet përgjatë gjithë vlefshmërisë se kontratës.

AK, para publikimit te njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, kane mundur te kërkojne sqarim plotësim – DEKLARATE, nga OE, dhe te marrin konfirmim për përmbushjen e tërësishme te kontratës dhe realizimin e pozicionit te përcaktuar ne aneksin 1, dhe te ofruar si çmim ne paramas dhe parallogari, ku ne si kompani edhe përmes kësaj kërkese për ri shqyrtim e konfirmojmë se realizmi i projektit do te realizohet sipas kërkesave – Specifikacioneve teknik te Detyrueshme me çmimin e ofruar ne paramase dhe parallogari.

Ne si OE e kemi kuptu dhe me vetedije te plote ne Listen e cmimeve kemi ofertu me cmim per trajtimet per 2 here qe do te behen pergjate vlefshmerise se kontrates,

Te konfirmuara dhe ne Kerkesen per Rishqyrtim dhe Deklaraten, date 14.11.2023

- PROVE. 1: Deklarata PROGLOBAL dorezu me kerkesen per ri-shqyrtim

-

Pikërisht për ketë çështje vet prodhuesi ynë "Emme Antincendio Srl, ka ofruar letër garancionin për mirëmbajtjen dhe pajisjet e zjarrëfikjes, ku është ofruar garancioni për Pluhurin e aparatit prej 3 viteve, po ashtu vet prodhuesi deklaron se Testi duhet te behet çdo 3 vite me një presion hidrostatik.

- PROVE. 2: Letër garancioni i prodhuesit Emme Antincendio Srl

Projektet e tilla – përshkrimet e tilla për pozicion identik ne si OE kemi kontraktuar, kemi realizuar dhe jemi ne realizim e sipër ku çmimi ne paramase eshtë përcaktuar ngjashëm me

AK MPB por realizimin e pozicionit e kemi aplikuar sipas rregullave dhe mënyrës e cila eshtë e obligueshme për pajisjen përkatëse.

- PROVË. 3: Kontrata dhe listën e çmimeve për projekte identike te AK:

- Spitali i Pergjithshem ne Peje

- Agjencioni i Menaxhimit te Emerxhencave

- Komuna e Prishtines

7/4

2. Propozimi për anulim te aktivitetit te prokurimit ne ketë faze te prokurimit madje edhe pas vendimit te OSHP-se dhe obligimit te dhëne ne te për Rivlerësim te ofertave, zyrën e prokurimit dhe komisionin e ri vlerësimit te ofertave duhet te japë përgjegjësi meqë një gjë e tille eshtë e ndaluar me nenin 59, par 1 ku përcaktohet se: Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.

Përderisa paragrafi 4 i te njëjtit nene përcakton qe:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

? Nga faza e Njoftimit per kontrate deri me daten e dorezimit te ofertave, nga OE te interesuar, perfshi 3 OE qe kane dorezu oferte nuk ka pasur Kerkesa per Sqarime, qka nenkupton se DT ka qene e formuluar si duhet ne tanesi. Kushtet e FDT, Aneksi 1 perfshi Listen e cmimeve nuk ka pasur nevoje te sqarohen.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Specifikacioni teknik "Matja e Hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit në ndërtesat Qeveritare" ,

? Pika 1. dhe 3. Eshte e kuptueshme plotesisht, Nenkupton - Matjen nen presion dhe Rimbushjen e e aparateve kundër zjarrit në ndërtesat Qeveritare, TE TE GJITHA

TIPEVE (Aparatat me pluhur, CO2, Shkume, etj) ashtu si jane dhene ne Tabelen

e Ndërtesave me Aparate për Fikjen e Zjarrit,

? Pika 4. Eshte e kuptueshme plotesisht - Çdo pajisje për fikjen e zjarrit duhet

të jetë e testuar për shtypje (presion) të sigurt dhe në pajtim me standardet

origjinale të prodhuesit – kjo nenkupton se duhet te behet TESTIMI I

BOCES nen presion te shtypjes se lengut me presion sa 1.5 here me

presionin nominal te punes se aparatit zjarrfikes.

Pika 16. Afati i kontratës do të parashihet të përfundoj brenda 36 muaj (3 vite),

Faza e parë e trajtimit do të jete menjëherë me nënshkrim te kontratës, dhe

e dyta

dy (2) vite pas fazës së parë. dhe

Pika 17. OE duhet të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të kontratës e cila do

të

realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës së nënshkruar.

? Jane ne perputhje me standardet per mirembajtjen e aparatave zjarrfikes.

Atestimi duhet te mbahet cdo 3 vite, prodhuesit per pluhur japin garancion

3 vite

Kjo nenkutpon se per kohezgjatjen e kontrates prej 36 Muaj (3 vite) do te

behet

8/4

Matja hidrostatike/Atestimi nen presion dhe Rimbushja 2 here

Për konsistence dhe argumentim te shkeljes ligjore ne si OE se bashku me ketë ankese ju prezantojmë vendimet e OSHP-se atë me nr. 362/2022 dhe 342/2022, ku eshtë konstatuar se anulimi i aktivitetit te prokurimit pas vlerësimit te ofertave paraqet shkelje ligjore te nenit 62, te LPP-se, madje eshtë iniciuar procedurë ne KRPP, për zbatim te nenit 25, par 8 te LPP-se, revokimi i certifikatës ndaj zyrtareve përgjegjës.

Si përfundim ne si OE, bazuar ne prova, dëshmi dhe baze ligjore, kërkojmë qe për ketë

procedurë te prokurimit AK – MPB, te nxjerre ketë:

URDHËRESË

I. Te aprovohet ankesa jone ne tërësi si e bazuar .

II. Te urdhërohet AK – MPB qe lëndën ta ktheje ne Rivlerësim, dhe te zbatohet vendimi i OSHP-se, nr. 497/23, i dates 24.08.2023, i nxjerr për ketë procedurë te prokurimit dhe e konstatuar përgjegjshmëria e ofertës sonë.

Ne si OE ankues deri me tani si rezultat i shkeljeve ligjore te AK – MPB, jemi dëmtuar ne aspektin material dhe moral, qe nga fillimi aplikimi ne procedure, sigurimi i tenderit, hartimi – përpilimi i shkresave depozitat e shumë qeshje tjera, te cilat jemi te detyruar ti raportojmë dhe te kërkojmë përgjegjësi.

KRITERET PËR VLERËSIM

Vlera e parashikuar	2.6	**316,560.00 €**	
		Kërkesat e përshtatshmërisë: **d.Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë", se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile, i cili dokument duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.**	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:** **d.Çertifikatë nga Gjykata kompetente- (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noteriz nga institucioni kompetent në vendin tua themelimit), duhet të dorëzohen vetëm n tenderuesi fitues, para publikimit të dhën së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çërtifikatës nga Gjykata perkatëse, tende tij do të refuzohet si dhe do te konfiskoh sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Tenderuesin qe është listua në vendin e dytë.**

	Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **c. Autorizim ose licencim ose anëtarësim ne një organizate te veçantë për shërbime profesionale te lëshuar nga një autoritet përkatës.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **c.Kopja e Lejes e lëshuar nga institucionet Relevante për përdorimin e preparateve e kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit te Republikës se Kosovës.**
	Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje).**
			2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 14001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.	**2. Certifikata ISO 14001 2015 (kopje).**
			3. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.	**3. Certifikata ISO 45001 2018 (kopje).**
			4.Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi Një (1) Agronom ose Veterinar ose Ekolog, (sipas MBPZHR)	**4. Diplomiplomë, Univrsitare, Liqencë P – valide, për Agronom ose Veterinar ose Ekolog, kontrata ose marrëveshja e pu valide për këtë projekt**
			5.Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të dëshmojë Një (1) teknik të veterinarisë	**5.Diplomë ose certifikatë – kopje, Liqen punës-valide kopje, kontrata ose marrëveshje e punës valide për këtë projekt.**
			6.Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të	**6.Kontrata ose marrëveshja e punës val për këtë projekt.**

			dëshmojë Minimumin 6. Punëtorë	
			7.Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të dëshmojë Minimumin një (Gjeneratorë Ultra Low Volume ULV) që vendosen ne Kamionet (pick ap); Minimum tri – Pompa Motorike; Minimum Tri – ULV Elektrike; Minimum tri ULV Elektronike; Minimum tri Pompa me presion ; Minimum një pajisje adekuate për Insekte me avull te Nxehtë me Temperature nga 100-1800 C	**7.Operatori Ekonomik duhet te ofrojë n listë me foto për të gjitha pajisjet e kërk për realizimin e këtij projekti, lista duhe jetë e nënshkruar dhe e vulosur si dhe dëshmitë e posedimit të tyre. Operator Ekonomik për të gjitha pajisjet duhet te ofroj dëshmitë Faturë, Dud Doganor apo marrëveshje te marrjes me qira, ku edh qiradhënësi duhet ti ofroj dëshmitë e posedimit (Faturë, DUD)**
			8. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë Katalog ose Broshurë me përshkrim teknik dhe foto për të gjithë preparatet e kërkuara.	**8. Operatori Ekonomik (OE) , duhet te sj katalogët ose broshura për preparatet e kërkuara, Katalogët ose Broshurat, duhe jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe të jenë në përputhje me kërkesat ne Anek të dosjes se tenderit.**
			9. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë Certifikatat e Origjinës dhe te kualitetit të produktit të cekur ne specifikim teknik ne D.T. për të gjitha preparatet e kërkuara te specifikuara ne specifikimet teknike.	**9. Certifikatat e Origjinës dhe te kualite të produktit të cekur ne specifikim tekn Dosjen Tenderit. (kopje)**
			10. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë duhet te kenë te përfunduar kontrata për shërbimet të ngjashme, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo më pak se 200,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	**10. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranues Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi ko e certifikatës, (certifikatave) ose refere të nënshkruara nga pranuesi i shërbime për kontratat dhe projektet e caktuara listë.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

1. Pretendimet tuaja ankimore mbi kërkesat teknike dhe profesionale, së janë shkelur nenet e lartë cekura, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse me këto kërkesa të vendosura nuk kemi të bëjmë me kurrfarë diskriminimi dhe trajtim të pabarabartë për Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë vendosur dhe kërkuar nga AK, në pajtim me LPP-në, neni 69, këto kërkesa të kualifikimit profesionale dhe edukative të stafit menaxherial dhe stafit profesional. janë kërkesa minimale për këtë projekt me rëndësi të veçantë për AK, të cilat kërkesa përcaktojnë dhe sigurojnë Autoritetin Kontraktues për nivelin e mirëmbajtjes, menaxhimit kualitativ dhe profesional te projektit nga ana e kompanisë ofertuese, proces te menaxhimit dhe realizimit kualitativ te këtyre shërbimeve komplekse.
Këto kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë minimale dhe në harmoni me LPP-në.
AK, për Stafin profesional për realizim të këtij projekti, nuk ka kërkuar ti kenë në marrëdhënie pune por ka mundësuar që Operatori Ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të asnjë Neni të LPP-së.

AK – është në harmoni të plotë me Neni 69 të LPP-së: paragrafi;

4. Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e lyre

5

për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë njeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:

4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;

4.4. raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit;

4.5. raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve;.

Duke u mbështetur në shtjellimet e lartë cekura, kompleksitetit të këtij aktivitet të prokurimit i cili ka të bëj me shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim në ndërtesat qeveritare dhe përdorimi e preparateve me materie të rrezikshme ku ky shërbim duhet të kryhet në ambiente të cilat janë të mbushura me staf (njerëz) dhe në të njëjtën kohë kemi të bëjmë me ruajtje e shëndetit të përgjithshëm publik AK edhe një here konstaton që kërkesat e vendosura janë minimal jo diskriminuese dhe të domosdoshme për realizim të këtij projekti.

2. Pretendimet tuaja ankimore për specifikat teknike, së janë shkelur nenet e lartë cekura, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk qëndron dhe është i pabazuar ky pretendim, sepse të gjithat specifikimet teknike janë në harmoni me nevojat e AK jo diskriminuese dhe favorizuese për asnjë OE, dhe janë të hartuara nga struktura të specializuara të njësisë së kërkesës të cilat janë për përputhje të plotë me LPP-në dhe nevojat e AK-së, mbetet përgjegjësi e OE-së që shpallet fitues deponimi i materialeve (si brejtësve zvarranikëve etj.) sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovë për asgjësim dhe kompetencave ligjore mbi të cilat operon veprimtaria e biznesit.

Edhe një here ju sqaroj së është në kompetencë të plotë ligjorë të AK-së vendosja e kritereve specifike dhe hartimi i specifikave teknike në harmoni me natyrën e AP-së.

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore të gjitha janë të cekura më lartë.

Në zbatim të, *Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092* Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim:

Konkluzion:

I. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina, **e pa bazuar**, kundër Njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për tenderin "Shërbime për Deratizim, Dezenfektim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare- ritender" me nr prokurimi: 214-23-13757-2-1-1.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-se PSH.nr.529/23.

Vendimi i OSHP-se PSH.nr.283/22.

Vendimi i OSHP-se PSH.nr.492/18.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi I parë ankimorë sipas ankesës nr.66/24 është se AK përmes dosjes së tenderit, ka vënë kritere diskriminuese duke kërkuar tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional për shkak se kërkon Agronom, ose Veterinar ose Ekolog, sipas MBPZHR, kurse e ka hequr Epidemiolog, i cili (sipas OE ankues) në bazë të kësaj nuk ka mbrojtje shëndetësore publike, as nuk duhet të jetë Agronomi apo Ekologu, por duhet të jetë gjithsesi Epidemolog, pasi që i njëjti për këto veprimtari duhet të jetë domosdoshmërish.

Në rastin konkret vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht I bazuar, në kuptimin e asaj se heqja e mundësisë të ofertohet me Epidemiolog është diskriminuese, pasi është ministria përkatëse e cila përcakton kërkesat dhe kualifikimet e stafit për ti pajisur kompanitë me licencë për ushtrimin e veprimtarisë DDD.

Në të njëjtën kohë nuk pajtohemi me pretendimin e OE ankues se "as nuk duhet të jetë Agronomi apo ekologu", pasi siç e cekëm më lart, është ministria përkatëse që I dikton kërkesat edhe kualifikimet e stafit për ti pajisur kompanitë me licencë për dezinfektim (DDD).

Meqenëse ushtrimi I kësaj veprimtarie, kërkesat dhe kualifikimet përcaktohen nga institucioni përkatës (me rastin e licencimit), konsiderojmë se nuk është kompetencë autoriteteve kontraktuese e as e OSHP-së përcaktimi I kualifikimeve përderisa kompania është licencuar.

Për këtë problematikë kemi disa vendime te OSHP-se qe janë përshkruar me lart ne këtë raport.

Andaj propozojmë që të korrigjohet dosja duke lejuar gjitha profesionet që parashihen në licencë të ministrisë përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Pretendimi nr.2

OE pretendon se kërkesa për Teknik të veterinarisë i cili nuk është i domosdoshëm dhe është dashtë të lejohet edhe mundësia për Teknik sanitar.

Vlerësimi ekspertit është se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Për më tepër konsiderojmë se kërkesa për Teknik të veterinarisë duhet të hiqet në tërësi pasi nuk është relevante me aktivitetin për dezinfektim të "objekteve qeveritare" dhe konsiderojmë se është kundërshtim me nenin 51 par.3 të LPP-së.

Pretendimi nr.3

Pretendimet ankimore tjera siç janë numri punëtorëve, numri mjeteve/pajisjeve, repelentët e zvarranikëve etj , për të cilat OE ankues konsideron se janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për realizimin e kësaj kontrate, vlerësojmë se mbetet në përgjegjësi të AK-së caktimi i këtyre kërkesave pasi eksperti shqyrtues nuk ka kapacitetin profesional/logjistikën për të identifikuar dhe diktuar AK-së numrin e punëtorëve dhe numrin/llojet e mjeteve/preparateve për realizimin e kësaj kontrate.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Ilir Halili